

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes Medina Brahaj, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Shtimes
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Nga:	Venera Çerkini, U.D e Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL Datë: 04..04.2019 Nr.020-372
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Shtimes
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës


I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Npi-01/79 për bashkëpunim ndër komunal më komunën e Ferizajt.
I miratuar më datë: 28.03.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.04.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Naim Ismaili, gradonačelnik Opštine Štimlje Medina Brahaj, predsedavajuća Skupštine opštine Štimlje	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>B.F. Todosijević</i> Rozafa Ukimeraj, generalni sekretar MALS-a <i>Rozafa Ukimeraj</i>	
Od:	Venera Çerkini, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS	Dana: 04.04.2019. Br. 020-372
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Štimlje	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovana predsedavajuća,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka Npi.01/79 za međuopštinsku saradnju sa opštinom Uroševac.
Usvojena dana: 28.03.2019. godine
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 04.04.2019. godine


Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvoditi pravni efekat.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Npi – 01/79 datë: 28.03.2019

Duke u bazuar në nenin 40.2.d, nenin 28, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 7 të Ligjit për Bashkëpunimin Ndërkomunal Nr.04/10; Rregulloren për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal Nr.09/2013; Si dhe nenit 46 të Statutit të Komunës së Shtimes, Nr.01/Nr.06/1636 datë 03.09.2008, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2019, ka analizoi propozimin e Kryetarit të Komunës për bashkëpunimin ndërkomunal me Komunën e Ferizajt, dhe aprovoi këtë:



V E N D I M

PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL ME KOMUNËN E FERIZAJT

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 2019, të mbajtur më 28.03.2019, me shumicën e votave aprovoi, Vendimin për bashkëpunimin ndërkomunal, që do të zhvillohet ndërmjet dy Komunave në vijim:

- Komuna e Shtimes
- Komuna e Ferizajt.

II

Qëllimi i bashkëpunimit është realizimi i projektit në fushën e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturë: 1. Rregullimi infrastrukturës në Zonën Ekonomike (Gllavicë – Koshare) dhe 2. Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçiklistëve në Zonën Turistike, Parku i Lirisë (Koshare – Shtime).

III

Projektet do të zbatohen në mbështetjen e Fondit të bashkëpunimit Ndërkomunal 2019, bazuar në Thirrjen për Aplikime për Financimin e projekteve për Bashkëpunimin Ndërkomunal MAPL 454-197, datë 27.02.2019.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

V

Komuna e Shtimes projektin e paraqitur më lartë Rregullimi i infrastrukturës në Zonën Ekonomike në Gllavicë e ka të paraparë në buxhetin komunal për vitin 2019, dhe me këtë rast parashihet pjesëmarrje në këtë projekt në vlerë prej 50,000 eurove, kodi projektit është 48348.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.



Kryesuesja e Kuvendit

Medina Brahaj
Medina Brahaj

Gëzim Sahiti

From: Lumnije Demi
Sent: 2019-04-04 3:07 MD
To: Gëzim Sahiti
Cc: Xhevat Tafa; Fetije Begolli
Subject: RE: Vendim për miratimin e bashkpunimit nderkomuanl i KK Shtime

I nderuar,
Vendimi eshte ne rregull sipas procedurave te Ligjit per Bashkepunim Nderkomunal.

Me respekt,
Lumnije Demi

From: Gëzim Sahiti
Sent: Thursday, April 4, 2019 2:52 PM
To: Lumnije Demi
Cc: Xhevat Tafa
Subject: RE: Vendim për miratimin e bashkpunimit nderkomuanl i KK Shtime

Pershendetje

Po ju percjellë Vendim për miratimin e projekteve për bashkëpunim ndërkomunal) te miratuar nga KK Shtime, ju lutem qe ju si Divizion perkatës të jepni mendimin se a është ne rregull dhe a l plotwson kushtet ky vendim pwr ta konfirmuar ligjshmerinë

-----Original Message-----

From: Lumnije Demi
Sent: 2019-04-03 2:11.MD
To: Gëzim Sahiti <Gzim.Sahiti@rks-gov.net>
Cc: Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Venera Çerkini <Venera.Cerkini@rks-gov.net>
Subject: RE: Vendim për miratimin e projekteve për bashkëpunim ndërkomunal (Ferizaj dhe Shtime)

I nderuar Gzim,
Vendimi i K.K te Ferizajt eshte ne rreftull, i bazuar ne Ligjin per Bashkepunim Nderkomunal.

Me respekt,
Lumnije Demi

From: Gëzim Sahiti
Sent: Wednesday, April 3, 2019 8:55 AM
To: Lumnije Demi
Cc: Xhevat Tafa; Venera Çerkini
Subject: FW: Vendim për miratimin e projekteve për bashkëpunim ndërkomunal (Ferizaj dhe Shtime)

Pershendetje

Po ju percjellë Vendim për miratimin e projekteve për bashkëpunim ndërkomunal (Ferizaj dhe Shtime) te miratuar nga KK Ferizaj, ju lutem qe ju si Divizion perkatës të jepni mendimin se a është ne rregull dhe a l plotwson kushtet ky vendim pwr ta konfirmuar ligjshmerinë.

Me respekt!